



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 115, datë 06.06.2019

PËR

**MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE, NDAJ VLERËSUESIT TË DËMEVE NË
SIGURIME ZJ. EDINA ZHABJAKU**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 235 dhe nenit 152 pika 1, germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

BSHS, me shkresën nr. 1192 prot., datë 18.02.2019, ka depozituar në Autoritet disa akte vlerësimi të hartuar nga kjo vlerësuese dëmsh, me kërkesën për rishikimin e tyre nga Autoriteti për shkak se janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Zj. Edina Zhabjaku, vlerësuese e pavarur e dëmeve në sigurime, licencuar me nr. 147, datë 27.07.2017 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime ka kryer akt vlerësim dëmi në disa variante për një ngjarje sigurimi.

Nga verifikimi i akteve të vlerësimit konstatohet se:

Vlerësimi i dëmit pasuror dhe jopasuror për rastin e të ndierit z. Shaqir Lika është bërë në tre variante. Në variantin e parë vlerësimi është bërë në rregull sipas Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar.

Në variantin e dytë dëmi moral dhe ekzistencial është llogaritur si dy figura të veçanta, ku vlera për secilën është marrë ajo që në fakt sipas Rregullores 53, datë 25.06.2009, i takonte të ishte për të dyja bashkë.

Ndërsa në variantin e tretë për dëmin moral dhe ekzistencial është llogaritur si vlerë dëmshpërblimi kufiri i mbulimit i përcaktuar sipas Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, për këtë figurë dëmi prej 1,000,000 lekë, duke e llogaritur për çdo trashëgimtar më vete.

Autoriteti, i ka dërguar shkresë vlerësueses së pavarur zj. Edina Zhabjaku, duke e informuar rreth pretendimeve të BSHS-së dhe duke i caktuar takim pranë zyrave të AMF-së, në datën 18.03.2019, ora 11:00, për t'u dëgjuar për çdo sqarim apo observacion lidhur me këtë konstatim.

Vlerësuesja e pavarur zj. Edina Zhabjaku nuk është paraqitur në takim, por pretendimet e saj i ka parashtruar me shkresën e regjistruar në AMF nr. 914/1 datë 18.03.2019.

Referuar shkresës së mësipërme, rezulton se pretendimet e vlerësueses së pavarur zj. Zhabjaku, për aktet e vlerësimit që kanë të bëjnë me rastin e të ndjerit z. Shaqir Lika në disa variante, janë kryer me kërkesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenin 224 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 152, pika 1) gërma a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërohet vlerësuesja e pavarur zj. Edina Zhabjaku, si më poshtë:
 - i. Të kryejë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në përputhje me legjislacionin në fuqi në sigurime;
 - ii. Të bëjë vlerësime të paanshme duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi, sipas pikës 1, të nenit 233, të Ligjit nr. 52/2014.
2. Përsëritja e shkeljeve të mësipërme, do të jetë objekt i masave të përshkallëzuara konform legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI